



# Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (SUE)

**Miratuar nga Grupi Përcjellës i Bolonjës në shtator 2014  
Për miratim në Konferencën Ministrore në maj 2015**

nga

**Asociacioni European për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë**

**Unioni i Studentëve European**

**Asociacioni i Universiteteve Europiane**

**Asociacioni European i Institucioneve të Arsimittë Lartë**

**Arsim Ndërkombëtar**

**BUSINESSEUROPE**

**Regjistri European i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë**

**Shtator 2014**

## **Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë**

Versioni ne gjuhen angleze i SUE eshte versioni i vetem zyrtar. Palet te cilat kane bere perkthimin, mbajne pergjegjesi per cdo pasaktesi te dokumentit.

The English version of the ESG is the only official version. The translating parties bear the responsibility of any inaccuracies.

## Përmbajtja

Hyrje.....	4
I. Konteksti, qëllimet dhe parimet .....	6
Vendosja e kontekstit.....	6
Qëllimet dhe konceptet .....	7
SUE: Qëllimet dhe parimet.....	5
II. Standardet dhe udhëzimet europiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë...11	
Pjesa 1: Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë .....	12
Pjesa 2: Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e jashtëm të cilësisë.....	22
Pjesa 3: Standardet dhe udhëzimet për agjencitë e sigurimit të cilësisë .....	28
III. Shtojcë: Lista përmbledhëse e standardeve .....	33

## Hyrje

*Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (ESG/SUE) u miratuan nga ministrat përgjegjës për arsimin e lartë në vitin 2005, pas një propozimi të përgatitur nga Asociacioni European për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) në bashkëpunim me Unionin e Studentëve European (ESU)<sup>1</sup>, Asociacionin European të Institucioneve të Arsimit të Lartë (EURASHE) dhe Asociacionin e Universiteteve Europiane (EUA).*

Që nga viti 2005, është bërë progres i konsiderueshëm në sigurimin e cilësisë, si dhe në vija të tjera veprimi të Bolonjës si kornizat e kualifikimit, njohja dhe promovimi i përdorimit të rezultateve mësimore, të gjitha këto në kontribut të një zhvendosjeje të paradigmës drejt mësimnxënies dhe mësimdhënies me qendër studentin.

Duke marrë parasysh kontekstin e ndryshuar, në 2012-ën, Komunikata Ministrore ftoi Grupin E4 (ENQA, ESU, EUA, EURASHE) në bashkëpunim me Arsimi Ndërkombëtar (EI), BUSINESSEUROPE dhe Regjistrin European për Sigurimin e Cilësisë së Arsimit të Lartë (EQAR) për të përgatitur propozimin fillestar për ESG-të e rishikuara “për të përmirësuar qartësinë, zbatueshmërinë dhe dobishmërinë, duke përfshirë qëllimet”.

Rishikimi përfshiu disa rrethe konsultimesh si me organizatat aktore kyçe, ashtu edhe me ministritë. Komentet e shumta, propozimet dhe rekomandimet e pranuar janë analizuar me kujdes dhe janë marrë shumë seriozisht nga Grupi Drejtues (SG). Ato janë reflektuar në propozimin drejtuar Grupit Përcjellës të Bolonjës. Për më tepër, propozimi gjithashtu reflekton një konsensus mes të gjitha organizatave të përfshira mbi atë se si duhet të çohet përpara sigurimi i cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë dhe si i tillë përbën një bazë të sigurt për zbatim të suksesshëm.

Duke qenë besimplotë se versioni i rishikuar i ESG do të jetë i dobishëm dhe frymëzues, ne ftojmë ministrat të miratojnë propozimin.

Asociacioni European për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA)

Unioni i Studentëve European (ESU)

Asociacioni i Universiteteve Europiane (EUA)

Asociacioni European i Institucioneve të Arsimit të Lartë (EURASHE)

Në bashkëpunim me:

---

<sup>1</sup>ESU njihej më parë si ESIB – Unionet Kombëtare të Studentëve

Arsimi Ndërkombëtar (EI)

BUSINESSEUROPE

Regjistri European i Sigurimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë (EQAR)

# I. Konteksti, qëllimet dhe parimet

## Vendosja e kontekstit

Arsimi i lartë, hulumtimi dhe inovacioni luajnë një rol kyç në mbështetjen e kohezionit social, rritjes ekonomike dhe konkurrencën globale. Duke marrë parasysh dëshirën e shoqërive europiane për të qenë gjithnjë e më shumë të bazuara tek njohuritë, arsimi i lartë është një përbërës thelbësor për zhvillimin socio-ekonomik dhe kulturor. Në të njëjtën kohë, rritja e kërkesës për aftësi dhe kompetenca kërkon që arsimi i lartë të përgjigjet në forma të reja.

Qasja më e gjerë në arsimin e lartë është një mundësi që institucionet e arsimit të lartë të përdorin përvojat e shumëllojshme individuale. Në përgjigje të shumëllojshmërisë dhe pritshmërive në rritje për arsimin e lartë, kërkohet një zhvendosje themelore në dispozitën e tij; kërkohet një qasje me studentin në qendër për mësimnxënien dhe mësimdhënien, përqafimi i rrugëve mësimore fleksible dhe njohja e kompetencave të fituara jashtë kurrikulës formale. Vetë institucionet arsimore janë bërë më të larmishme në misionet e tyre, në mënyrën në të cilën ofrojnë arsimin dhe bashkëpunimin, duke përfshirë rritjen e ndërkombëtarizimit, mësimin digjital dhe forma të reja të shpërndarjes.<sup>2</sup>Roli i sigurimit të cilësisë është thelbësor në garantimin e kualifikimeve të arritura nga studentët dhe përvoja e tyre në arsimin e lartë mbetet kryesore në misionet institucionale.

Një qëllim kyç i Standardeve dhe Udhëzimeve për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (ESG) është kontributi në mirëkuptimin e përbashkët të sigurimit të cilësisë për mësimnxënien dhe mësimdhënien përtej kufijve dhe ndër të gjithë aktorët. Ato kanë luajtur dhe do të luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e sistemeve kombëtare dhe institucionale për sigurimin e cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (HEAL) dhe në bashkëpunimin ndërkufitar. Angazhimi me proceset e sigurimit të cilësisë, veçanërisht ato të jashtme, i mundëson sistemeve europiane të arsimit të lartë të tregojnë cilësi dhe rritje të transparencës, duke ndihmuar kështu ndërtimin e besimit të përbashkët dhe njohje me të mirë të kualifikimeve, programeve dhe dispozitave të tjera.

---

<sup>2</sup>Komunikim nga Komisioni Europian: Hapja e Arsimit: Mësimdhënia dhe Mësimnxënia inovative për të gjithë përmes teknologjive dhe Burimeve të Hapura Arsimore COM(2013) 654 final, [http://ec.europa.eu/education/nees/doc/openingcom\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/education/nees/doc/openingcom_en.pdf)

ESG-të përdoren nga institucionet dhe agjencitë e sigurimit të cilësisë si dokument referues për sistemet e sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. Për më tepër, ato përdoren nga Regjistri European për Sigurimin e Cilësisë (EQAR), që është përgjegjës për regjistrat e agjencive të sigurimit të cilësisë që përputhen me ESG-në.

## **Qëllimet dhe Konceptet**

ESG-të janë një përmbledhje e standardeve dhe udhëzimeve për sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë. ESG-të nuk janë standard për cilësinë dhe as nuk përshkruajnë se si zbatohen proceset e sigurimit të cilësisë, por japin udhëzime, duke mbuluar fushat që janë vitale për dispozita të suksesshme të cilësisë dhe mjediseve mësimore në arsimin e lartë. ESG-ja duhet të konsiderohet në një kontekst më të gjerë që përfshin gjithashtu kornizat e kualifikimeve, ECTS-ve dhe dhënien e diplomës që gjithashtu kontribuojnë në promovimin e transparencës dhe në besimin e përbashkët në HEAL.

**Fokusi i ESG-së është mbi sigurimin e cilësisë lidhur me mësimnxënien dhe mësimdhënien në arsimin e lartë, duke përfshirë mjedisin e mësimi dhe lidhjet relevante për hulumtim dhe inovacion.** Përveç kësaj, institucionet kanë politika dhe procese që garantojnë dhe përmirësojnë cilësinë e aktiviteteve të tyre, si hulumtimi dhe qeverisja.

**ESG zbatohen mbi të gjithë arsimin e lartë të ofruar në HEAL pavarësisht modusit të studimit apo vendit të shpërndarjes.** Kështu, ESG-të janë gjithashtu të zbatueshme në të gjithë arsimin e lartë, duke përfshirë dispozitën ndër-nacionale dhe ndër-kufitare. Në këtë dokument, termi “program” i referohet arsimin të lartë në të gjithë sensin, duke përfshirë atë që nuk është pjesë e programit që sjell një gradë shkencore zyrtare.

Arsimi i lartë synon të përmbushë qëllime të shumta; duke përfshirë përgatitjen e studentëve për të qenë qytetarë aktiv, për karrierat e tyre të ardhshme (p.sh. kontribuimi në mundësitë e punësimit), mbështetjen e zhvillimit të tyre personal, krijimin e njohurive të avancuara dhe stimulimin e hulumtimit dhe inovacionit<sup>3</sup>. Rrjedhimisht, aktorët, që mund të vendosin prioritete mes qëllimeve të ndryshme, mund të shohin cilësinë në arsimin e lartë në mënyrë të ndryshme dhe nevojat e sigurimit të cilësisë që të kenë parasysh këto perspektiva të ndryshme. Cilësia, ndonëse jo e lehtë për t'u përkufizuar, është kryesisht rezultat i ndërveprimit mes mësimdhënësve, studentëve dhe mjedisit mësimor institucional. Sigurimi i cilësisë duhet të garantojë një mjedis mësimor ku përmbajtja e programeve, mundësitë e mësimin dhe pajisjet të jenë të përputhshme me qëllimin.

Në zemër të të gjithë aktiviteteve të sigurimit të cilësisë janë qëllimet binjakë të *llogaridhënies dhe përmirësimit*. Të marrë së bashku, këto krijojnë besim në performancën e institucionit të arsimit të lartë. Një sistem i zbatuar suksesshëm për sigurimin e cilësisë do të siguronte informacion për të garantuar institucionit të arsimit të lartë dhe publikut për cilësinë e aktiviteteve të institucionit të arsimit të lartë (llogaridhënia) si dhe dhënia e këshillave dhe rekomandimeve mbi si mund të përmirësohet ajo çka po bëhet (përmirësimi). Sigurimi i cilësisë dhe përmirësimi i cilësisë janë kësajsoj të ndërlidhura. Ata mund të mbështesin zhvillimin e një *kulture për cilësinë* që përqafohet nga të gjithë: nga të gjithë studentët dhe stafi akademik deri tek udhëheqësit dhe menaxhmenti institucional.

**Termi: sigurimi i cilësisë” përdoret në këtë dokument për të përshkruar të gjitha aktivitetet në ciklin e vazhdueshëm të përmirësimit (p.sh. aktivitetet e sigurimit dhe përmirësimit).**

---

<sup>3</sup>Rekomandim Rec (2007)6 nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Europës mbi përgjegjshmërinë publike për arsimin e lartë dhe hulumtimin,  
[http://www.coe.int/t/dg4/highereducation/Neës/pub\\_res\\_EN.pdf](http://www.coe.int/t/dg4/highereducation/Neës/pub_res_EN.pdf)



Përveç nëse është specifikuar ndryshe, në këtë dokument *palët e interesuara* mbulojnë të gjithë aktorët e institucionit, duke përfshirë studentët dhe stafin, si dhe aktorët e jashtëm si për shembull të punësuarit dhe partnerët e jashtëm të një institucioni.

Fjala *institucion* përdoret në standardet dhe udhëzimet për t'iu referuar institucioneve të arsimit të lartë. Varësisht qasjes të institucionit mbi sigurimin e cilësisë, ajo megjithatë i referohet institucionit si një i tërë ose çdonjërit prej aktorëve në këtë institucion.

### **ESG: qëllimet dhe parimet**

Qëllimet e ESG-ve janë si në vijim:

- **Ato caktojnë një kornizë të përbashkët** për sistemet e sigurimit të cilësisë për mësimnxënien dhe mësimdhënien në nivel evropian, kombëtar dhe institucional
- **Ato mundësojnë sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë** të arsimit të lartë në hapësirën europiane të arsimit të lartë
- **Ato mbështesin besimin e përbashkët**, duke lehtësuar kështu njohjen dhe lëvizshmërinë brenda dhe ndër kufijtë kombëtarë
- **Ato ofrojnë informata mbi sigurimin e cilësisë** në HEAL.

Këto qëllime ofrojnë kornizën brenda së cilës ESG mund të përdoret dhe të zbatohet në mënyra të ndryshme nga institucione, agjenci dhe vende të ndryshme. HEAL karakterizohet nga shumëllojshmëria e sistemeve politike, sistemeve të arsimit të lartë, traditave kulturore dhe arsimore, gjuhëve, aspiratave dhe pritshmërive. Kjo e bën të papërshtatshme një qasje të vetme monolitike për cilësinë dhe sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë. Pranimi i gjerë i të gjitha standardeve është parakushti për të krijuar mirëkuptimin e përbashkët për sigurimin e cilësisë në Europë. Për këto arsye, ESG duhet të jenë të një niveli gjenerik të arsyeshëm me qëllim që të garantojnë se ato janë të zbatueshme në të gjitha format e dispozitave.

ESG siguron kriteret në nivel europian mbi bazën e të cilave vlerësohen agjencitë e sigurimit të cilësisë dhe aktivitetet e tyre<sup>4</sup>. Kjo garanton që agjencitë e sigurimit të cilësisë në HEAL aderojnë në të njëjtën bashkësi parimesh dhe se proceset dhe procedurat janë modeluar për t'iu përshtatur qëllimeve dhe kërkesave të konteksteve të tyre.

ESG-të janë bazuar në katër parimet e mëposhtme për sigurimin e cilësisë në EHEA:

- Institucionet e arsimit të lartë kanë përgjegjësi primare për cilësinë e ofrimit dhe sigurimit të saj;
- Sigurimi i cilësisë i përgjigjet shumëllojshmërisë të sistemeve të arsimit të lartë, institucioneve, programeve dhe studentëve;
- Sigurimi i cilësisë mbështet zhvillimin e një kulture për cilësinë;
- Sigurimi i cilësisë merr parasysh nevojat dhe pritshmëritë e studentëve, të gjithë palëve të interesit dhe shoqërisë.

---

<sup>4</sup>Agjencitë që aplikojnë për përfshirje në Regjistrin Europian të Sigurimit të Cilësisë (EQAR) i nënshtrohen një vlerësimi të jashtëm për të cilin ESG-ja siguron kriteret. Gjithashtu Asociacioni Europian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ENQA) mbështetet në përputhshmërinë me ESG-në kur është në pyetje dhënia e statusit të anëtarësisë së plotë në organizatë e Agjencive për Sigurimin e Cilësisë.

## II. Standardet dhe udhëzimet europiane për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë

Standardet për sigurimin e cilësisë janë ndarë në tre pjesë:

- Sigurimi i brendshëm i cilësisë
- Sigurimi i jashtëm i cilësisë
- Agjencitë për sigurimin e cilësisë

Duhet pasur parasysh se megjithatë të tre pjesët janë të ndërlidhura thelbësisht dhe së bashku formojnë bazën për një kornizë europiane të sigurimit të cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në pjesën 2 njeh standardet për sigurimin e brendshëm të cilësisë në Pjesën 1, duke garantuar kështu se puna e brendshme e ndërmarrë nga institucionet është direkt relevante me çdo sigurim të jashtëm të cilësisë që ato i nënshtrohen. Në të njëjtën mënyrë Pjesa 3 i referohet Pjesës 2. Kësisoj, këto tre pjesë funksionojnë në bazë plotësuese në institucionet e arsimit të lartë, si dhe në agjencitë dhe funksionojnë mbi mirëkuptimin se palët e tjera të interesuara i kontribuojnë kësaj gjendjeje. Si rrjedhojë e kësaj, të tre pjesët duhet të lexohen si një e tërë.

*Standardet* e përcaktuara janë praktika të dakorduara dhe pranuar në praktikën për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në HEAL dhe duhet që të merren parasysh dhe të respektohen nga të interesuarit, në të gjitha llojet e ofertave të arsimit të lartë.<sup>5</sup>Lista përmbledhëse e standardeve për sigurimin e cilësisë është vendosur në shtojcë për lehtësi në referencë.

*Udhëzimet* shpjegojnë pse standardi është i rëndësishëm dhe përshkruajnë se si mund të zbatohen standardet. Ato përcaktojnë praktikën e mirë për t'u konsideruar në fushën përkatëse nga aktorët e përfshirë në sigurimin e cilësisë. Zbatimi varion varësisht konteksteve të ndryshme.

---

<sup>5</sup>Standardet shfrytëzojnë përdorimin e zakonshëm të “should” në anglisht, që e ka domethënie tek receta dhe pajtueshmëria.

# Pjesa 1: Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë

## 1.1 Politikat për sigurimin e cilësisë

### **Standardi:**

Institucionet duhet të kenë politika për sigurimin e cilësisë që bëhen publike dhe përbëjnë pjesë të strategjisë së menaxhmentit. Aktorët e brendshëm duhet të zhvillojnë dhe të zbatojnë këtë politikë përmes strukturave dhe proceseve të përshtatshme, me përfshirjen e palëve të jashtme.

### **Udhëzime:**

Politikat dhe proceset janë shtyllat kryesore të një sistemi institucional koherent për sigurimin e cilësisë që formojnë një cikël për përmirësimin e vazhdueshëm dhe kontribuon në llogaridhënien e institucionit. Ai mbështet zhvillimin e një kulture për cilësinë në të cilën të gjithë palët e brendshme kanë përgjegjësi për cilësinë dhe angazhohen në sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet e institucionit. Për ta lehtësuar këtë, politika ka një status zyrtar dhe është publikisht qasshme.

Politikat për sigurimin e cilësisë janë më shumë efektive kur reflektojnë marrëdhënien mes hulumtimit dhe mësimnxënies & mësimdhënies dhe marrin parasysh kontekstin shtetëror ku vepron institucioni, kontekstin institucional dhe qasjen e tij strategjike. Një politikë e tillë mbështet:

- organizimin e një sistemi për sigurimin e cilësisë;
- departamentet, shkollat, fakultetet dhe njësi të tjera organizuese, si dhe i kërkon udhëheqjes institucionale, anëtarëve individualë të stafit mësimor dhe studentëve që të marrin përgjegjësi në sigurimin e cilësisë;
- integritetin dhe lirinë akademike dhe është vigjilente ndaj mashtrimit akademik
- udhëheqjen kundër jo tolerancës të çdo lloji apo diskriminimit kundër studentëve ose stafit;
- përfshirjen e palëve të jashtme në sigurimin e cilësisë.

Politika përkthehet në praktikë përmes një varieteti procesesh për sigurimin e brendshëm të cilësisë që mundëson pjesëmarrjen përtej vendimit të institucionit. Se si politika zbatohet, monitorohet dhe rishikohet është vendim i institucionit.

Politika për sigurimin e cilësisë mbulon gjithashtu çdo element të aktiviteteve të institucionit që janë nënkontraktuar ose janë kryer nga palë të tjera.

## 1.2 Hartimi dhe miratimi i programeve

### **Standardi:**

**Institucionet duhet të kenë proceset e tyre për hartimin dhe miratimin e programeve. Programet duhet të jenë hartuar në mënyrë të tillë që të përmbushin bashkësinë e objektivave, duke përfshirë rezultatet mësimore të synuara. Kualifikimi që rezulton nga programi duhet të specifikohet dhe të komunikohet qartësisht dhe t'i referohet nivelit korrekt të kornizës së kualifikimeve kombëtare për arsimin e lartë dhe rrjedhimisht Kornizës për Kualifikime në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë.**

### **Udhëzime:**

Programet e studimit janë baza e misionit mësimdhënës të institucioneve të arsimit të lartë. Ato prodhojnë student me njohuri dhe aftësi akademike, duke përfshirë ato që janë të transferueshme, që mund të ndikojnë në zhvillimin e tyre personal dhe të mund të aplikohen në karrierat e tyre të ardhshme.

### **Programet**

- janë të hartuara sipas objektivave të përgjithshme të programit që janë në përputhje me strategjinë institucionale dhe kanë rezultate mësimore të qarta;
- janë të hartuara duke i përfshirë në punë studentët dhe palët e përfshira;
- përfitojnë nga ekspertiza e jashtme dhe nga pikët e referencës;
- reflektojnë katër qëllimet e Këshillit të Europës Për Arsimin e Lartë (Qëllime dhe Koncepte);
- janë të hartuara kështu që mundësojnë progres të rrjedhshëm të studentëve;
- përkufizojnë ngarkesën e pritshme të punës për studentët, p.sh. në ECTS;
- përfshijnë mundësi punësimi të mirë-strukturuar aty ku është e përshtatshme;<sup>6</sup>

<sup>6</sup>Punësimet përfshijnë trajnimet, praktikat dhe periudha të tjera të programit që nuk shpenzohen në institucion, por që i mundësojnë studentit të fitojë përvojë në fushën e lidhur me studimet e tij.

- i nënshtrohen një procesi miratimi institucional formal;

### 1.3 Mësimnxënia, mësimdhënia dhe vlerësimi me studentin në qendër

**Standardi:**

Institucionet duhet të garantojnë që programet të ofrohen në atë mënyrë që të inkurajojnë studentët të kenë rol aktiv në krijimin e procesit mësimor dhe që vlerësimet e studentëve të reflektojnë këtë qasje.

**Udhëzime:**

Mësimnxënia dhe mësimdhënia me studentin në qendër luan një rol të rëndësishëm në stimulimin e motivimit të studentëve, vetë-refleksionin dhe angazhimin në procesin mësimor. Kjo kërkon shqyrtim të kujdesshëm gjatë hartimit dhe ofrimit të programeve të studimit dhe vlerësimin e rezultateve.

Zbatimi i mësimnxënies dhe mësimdhënies me studentin në qendër

- respekton dhe ndjek diversitetin e studentëve dhe nevojave të tyre, duke i mundësuar metoda mësimore fleksibël;
- shqyrton dhe përdor mënyra të ndryshme të ofrimit, atje ku është e nevojshme;
- përdor në mënyrë fleksibël një varietet të metodave pedagogjike;
- vlerëson dhe përshtat rregullisht mënyrat e shpërndarjes dhe metodat pedagogjike;
- inkurajon një sens autonomie tek mësimmarrësi (nxënës), ndërsa garanton udhëzime të përshtatshme dhe mbështetje nga mësimdhënësi;
- promovon respektin e përbashkët në marrëdhënien nxënës-mësimdhënësi;
- ka procedura të përshtatshme për trajtimin e ankesave të studentëve.

Duke konsideruar rëndësinë e vlerësimit për progresin e studentëve dhe karrierat e tyre të ardhshme, procesi i sigurimit të cilësisë merr parasysh sa më poshtë:

- Vlerësuesit njohin metodat ekzistuese të testimit dhe provimit dhe marrin mbështetje për zhvillimin e aftësive të tyre në këtë fushë;
- Kriteret për metodën e vlerësimit, si dhe kriteret për korrigjimin publikohen paraprakisht;

- Vlerësimi u mundëson studentëve të tregojnë masën në të cilën janë arritur rezultatet mësimore të synuara. Studentët japin komentet (feedback) e tyre, të cilat, nëse është e nevojshme, përdoren për të këshilluar mbi procesin mësimor;
- Aty ku është e mundur, vlerësimi kryhet nga më shumë se një vlerësues
- Rregulloret për vlerësimin marrin parasysh rrethanat lehtësuese;
- Vlerësimi është i qëndrueshëm, zbatohet në mënyrë të drejtë për të gjithë studentët dhe kryhet në përputhje me procedurat e deklaruara
- Ka një procedurë formale për ankesat e studentëve.

#### **1.4 Pranimi, progresi, njohja dhe certifikimi i studentit**

##### **Standardi:**

Institucionet duhet të aplikojnë në mënyrë konsistente rregulloret e para-caktuara dhe të publikuara, që mbulojnë të gjitha fazat e “ciklit jetësor” të studentit, p.sh. pranimin, progresin, njohjen dhe certifikimin e studentit.

##### **Udhëzime:**

Garantimi i kushteve dhe mbështetjes që janë të nevojshme që studentët të kenë progres në karrierat e tyre akademike është në interesin më të mirë të studentëve, programeve, institucioneve dhe sistemeve. Është shumë e rëndësishme që pranimi, njohja dhe procedurat kompletuese të jenë të përshtatshme me qëllimin, veçanërisht kur studentët janë të lëvizshëm brenda dhe ndër sistemet e arsimit të lartë.

Është e rëndësishme që politikat e qasjes, proceset dhe kriteret e pranimit të zbatohen në mënyrë konsistente dhe në një mënyrë transparente. Hyrja në institucion dhe në program të jetë e siguar.

Institucionet kanë nevojë të vendosin në vend proceset dhe mjetet për të mbledhur, monitoruar dhe vepruar mbi informacionin e progresit të studentëve.

Njohja e drejtë e kualifikimeve të arsimit të lartë, periudhave të studimit dhe mësimin paraprak, duke përfshirë njohjen e mësimin jo formal dhe formal janë përbërës

thelbësorë për të siguruar progresin e studentëve në studimet e tyre, ndërsa promovohet lëvizshmëria. Procedurat për njohjen e përshtatshme mbështeten në

- praktikën institucionale për njohjen, duke qenë në përputhje me parimet e Konventës së Lisbonës për njohjen ;
- bashkëpunimin me institucione të tjera, agjencitë e sigurimit të cilësisë dhe qendrën kombëtare ENIC/NARIC për të garantuar njohjen koherente në gjithë vendin.

Diplomimi paraqet kulmin e periudhës së studimit. Studentët kanë nevojë të marrin dokumentacionin që shpjegon kualifikimin e fituar, duke përfshirë rezultatet mësimore dhe kontekstin, nivelin, përmbajtjen dhe statusin e studimeve të ndjekura dhe të përfunduara me sukses.

### 1.5 Stafi mësimdhënës

Standardi:

Institucionet duhet t'i garantojnë vet kompetencat e mësimdhënësve të tyre. Ato duhet të aplikojnë procese të ndershme dhe transparente për rekrutimin dhe zhvillimin e stafit.

#### Udhëzime:

Roli i mësimdhënësit është thelbësor për të krijuar një përvojë të cilësisë së lartë për studentin dhe për të mundësuar përfundimin e njohurive, kompetencave dhe aftësive. Larmia e studentëve dhe një fokus më i fuqishëm në rezultatet mësimore kërkojnë mësimnxënie dhe mësimdhënie me studentin në qendër dhe roli i mësuesit gjithashtu rrjedhimisht ndryshon. (Standardi 1.3)

Institucionet e arsimit të lartë kanë përgjegjësi parësore për cilësinë e stafit të tyre dhe për garantimin e një mjedisi mbështetës për ta që u mundëson të kryejnë punën e tyre në mënyrë efikase. Një mjedis i tillë

- vendos dhe ndjek procese të qarta, transparente dhe të ndershme për rekrutimin e stafit dhe kushtet e punës që njohin rëndësinë e mësimdhënies;
- ofron mundësi dhe promovon zhvillimin profesional të stafit mësimdhënës;



- inkurajon aktivitetet shkollore për të forcuar lidhjen mes arsimit dhe hulumtimit;
- inkurajon inovacionin në metodat mësimore dhe përdorimin e teknologjive të reja.

## 1.6 Burimet mësimore dhe mbështetja e studentëve

### **Standardi:**

**Institucionet duhet të kenë financim të përshtatshëm për aktivitetet e mësimnxënies dhe mësimdhënies dhe duhet të garantojnë sigurimin e burimeve të përshtatshme dhe të gatshme të mësimit dhe mbështetjen e studentëve.**

### **Udhëzime:**

Për një përvojë të mirë të arsimit të lartë, institucionet sigurojnë një gamë burimesh që ndihmojnë mësimnxënien e studentëve. Këto variojnë nga burimet fizike si biblioteka, pajisjet studimore dhe infrastruktura IT tek mbështetja njerëzore në formën e udhëheqësve, konsultuesve dhe këshilltarëve të tjerë. Roli i shërbimeve të mbështetjes është i një rëndësie të veçantë në lehtësimin e lëvizshmërisë të studentëve brenda dhe ndër sistemet e arsimit të lartë.

Nevojat e një popullimi të larmishëm të studentëve (si studentë të rregullt, me korrespondencë, të punësuar dhe ndërkombëtarë, si dhe studentët me aftësi të kufizuara) dhe zhvendosja drejt mësimit me studentin në qendër dhe mënyrat fleksibël të mësimnxënies dhe mësimdhënies merren në konsideratë kur bëhet caktimi, planifikimi dhe garantimi i burimeve mësimore dhe i mbështetjes të studentëve.

Aktivitetet mbështetëse mund të organizohen në mënyra të ndryshme, varësisht kontekstit institucional. Megjithatë, sigurimi i brendshëm i cilësisë garanton që të gjithë burimet të jenë të përshtatshme me qëllimin, të qasshme dhe që studentët të informohen rreth shërbimeve të mundshme për ta.

Në shpërndarjen e shërbimeve mbështetëse është shumë i rëndësishëm roli i stafit mbështetës dhe administrativ dhe rrjedhimisht këta të fundit duhet të jenë të kualifikuar dhe të kenë mundësi të zhvillojnë kompetencat e tyre.

## 1.7 Menaxhimi i informatave

**Standardi:**

**Institucionet duhet të garantojnë që ato mbledhin, analizojnë dhe përdorin informata me rendësi për menaxhimin efektiv të programeve të tyre dhe aktiviteteve të tjera.**

**Udhëzime:**

Të dhënat e besueshme janë shumë të rëndësishme për vendim-marrje të informuar dhe për të bërë me dije atë që po funksionon mirë dhe atë që ka nevojë për më shumë vëmendje. Proceset efektive për mbledhjen dhe analizën e informacionit rreth programeve të studimit dhe aktiviteteve të tjera ushqejnë sistemin e sigurimit të brendshëm të cilësisë.

Informacioni i mbledhur varet, deri në një masë, mbi llojin dhe misionin e institucionit. Më interes janë si në vijim:

- Treguesit kyçë të performancës;
- Profili i përbërjes së studentëve;
- Progresi, sukcesi dhe niveli i braktisjes së shkollës nga ana e studentëve;
- Kënaqshmëria e studentëve për programet e tyre;
- Burimet mësimore dhe mbështetja për studentët;
- Rrugët e karrierës për të diplomuarit.

Mund të përdoren metoda të ndryshme për mbledhjen e informacionit. Është e rëndësishme që studentët dhe stafi të përfshihen në analizën e informacionit dhe në planifikimin e aktiviteteve të ardhshme.

## 1.8 Informimi publik

**Standardi:**

Institucionet duhet të botojnë informacion rreth aktiviteteve të tyre, duke përfshirë programet, që të jetë i qartë, i saktë, objektiv, i përditësuar dhe i qasshëm pa vështirësi.

**Udhëzime:**

Informimi mbi aktivitetet e institucionit është i dobishëm për studentët e ardhshëm dhe aktualë, si dhe për të diplomuarit, palët e interesuara dhe publikun.

Rrjedhimisht, institucionet japin informacion rreth aktiviteteve të tyre, duke përfshirë programet që ofrojnë dhe kriteret përzgjedhëse për to, rezultatet mësimore të synuara për këto programe, kualifikimet që ato japin, procedurat e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit të përdorura për normat kaluese dhe mundësitë e mësimin për studentët e tyre, si dhe informata për punësimin e të diplomuarve.

## 1.9 Monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi ciklik i programeve

**Standardi:**

Institucionet duhet të monitorojnë dhe të vlerësojnë periodikisht programet e tyre që të sigurojnë se ato i arrijnë objektivat dhe i përgjigjen nevojave të studentëve dhe të shoqërisë. Këto rishikime duhet të sjellin përmirësimin e vazhdueshëm të programit. Cilido veprim i planifikuar apo i ndërmarrë si rezultat duhet t'u komunikohet të interesuarve.

**Udhëzime:**

Monitorimi i rregullt, vlerësimi dhe rishqyrtimi i programeve të studimit synojnë të garantojnë që dispozita mbetet e përshtatshme dhe të krijojnë një mjedis mësimor mbështetës dhe efektiv për studentët.

Ato përfshijnë vlerësimin e:

- Përmbajtjes së programit në dritën e hulumtimit më të fundit në disiplinën e dhënë, duke siguruar kështu që program është i përditësuar;
- Ndryshimin e nevojave të shoqërisë;
- Ngarkesën mësimore, progresin dhe kompletimin e studentëve;
- Efektshmërinë e procedurave të vlerësimit për studentët;
- Pritshmëritë, nevojat dhe kënaqshmërinë e studentëve në lidhje me programin;
- Mjedisin mësimor dhe shërbimet mbështetëse dhe përputhshmërinë e tyre për qëllimet e programit.

Programet vlerësohen dhe rishqyrtohen rregullisht duke i përfshirë studentët dhe palët e interesuara. Informacioni i mbledhur analizohet dhe programi përshtatet për të garantuar që ai është i përditësuar. Specifikimet e programit të rishikuar publikohen.

#### **1.10 Sigurimi i jashtëm ciklik i sigurisë**

**Standardi:**

**Institucionet duhet t'i nënshtrohen sigurimit të jashtëm të cilësisë në përputhje me ESG mbi një bazë ciklike.**

**Udhëzime:**

Sigurimi i jashtëm i cilësisë në forma të shumta mund të verifikojë efektshmërinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë së institucionit, të veprojë si një katalizator për përmirësimin dhe t'i ofrojë institucionit perspektiva të reja. Ai gjithashtu do të ofrojë informata për të siguruar institucionin dhe publikun për cilësinë e aktiviteteve të institucionit.

Institucionet marrin pjesë në sigurimin e jashtëm ciklik të cilësisë që merr parasysh, kur është relevante, kërkesat e kornizës ligjore në të cilën ato operojnë. Rrjedhimisht, varësisht kornizës, sigurim i jashtëm i cilësisë mund të marrë forma të ndryshme dhe të fokusohet në nivele të ndryshme organizuese (si program, fakulteti apo institucioni).

Sigurimi i cilësisë është një proces i vazhdueshëm që nuk mbaron me komentet apo raportin e jashtëm dhe proceset pasuese brenda institucionit. Rrjedhimisht, institucionet garantojnë që progresi i bërë që nga aktiviteti i fundit i sigurimit të jashtëm të cilësisë është marrë në konsideratë përderisa përgatisin aktivitetin e ardhshëm.

## **Pjesa 2: Standardet dhe udhëzimet për sigurimin e jashtëm të cilësisë**

### **2.1 Përdorimi i sigurimit të brendshëm të cilësisë**

**Standardi:**

**Sigurimi i jashtëm i cilësisë duhet t'i adresohet efektshmërisë të proceseve për sigurimin e brendshëm të cilësisë, të përshkruar në Pjesën 1 të ESG.**

**Udhëzime:**

Sigurimi i cilësisë në arsimin e lartë bazohet në përgjegjshmërinë e institucioneve për cilësinë e programeve të tyre dhe dispozitave të tjera; rrjedhimisht është e rëndësishme që sigurimi i jashtëm i cilësisë të njohë dhe të mbështesë përgjegjshmërinë institucionale për sigurimin e cilësisë. Për të siguruar lidhjen mes sigurimit të brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë, sigurimi i jashtëm i cilësisë përshin shqyrtimin e standardeve të Pjesës 1. Ato mund të adresohen në mënyrë të ndryshme, varësisht llojit të sigurimit të jashtëm të cilësisë.

### **2.2 Hartimi i metodologjive në përputhje me qëllimin**

**Standardi:**

**Sigurimi i jashtëm i cilësisë duhet të përcaktohet dhe të hartohet në mënyrë specifike që të garantojë përputhshmërinë e tij për arritjen e synimeve dhe objektivave, ndërsa merr në konsideratë rregulloret relevante. Të gjithë aktorët duhet të përfshihen në hartimindhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij.**

**Udhëzime:**

Në mënyrë që të garantohet efektshmëria dhe objektiviteti është shumë e rëndësishme që sigurimi i jashtëm i cilësisë të ketë synime të qarta për të cilat palët e interesuara kanë rënë dakord.

Qëllimet, objektivat dhe zbatimi i proceseve do të

- kenë parasysh nivelin e ngarkesës mësimore dhe koston që ato kanë mbi institucionin;
- marrë parasysh nevojën për të mbështetur institucionet që të përmirësojnë cilësinë;
- mundësojë institucioneve të demonstrojnë këtë përmirësim;
- rezultojë në informacion të qartë mbi rezultatet dhe pasojat.

Sistemi për sigurimin e jashtëm të cilësisë mund të operojë në mënyrë më fleksibël nëse institucionet janë në gjendje të demonstrojnë efektshmërinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë.

### 2.3 Proceset e zbatimit

**Standardi:**

**Proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë duhet të jenë të besueshme, të dobishme, të paracaktuara, të zbatuara në mënyrë konsistente dhe të publikuara. Ato përfshijnë:**

- një vetë-vlerësim ose të barasvlershmin e tij;
- një vlerësim të jashtëm duke përfshirë normalisht vizitën në terren;
- një raport që vjen nga vlerësimi i jashtëm;
- një përcjellje (ndjekje) e më pas e vazhdueshme.

**Udhëzime:**

Sigurimi i jashtëm i cilësisë i kryer në mënyrë profesionale, konsistente dhe transparente garanton pranueshmërinë dhe ndikimin e tij.

Varësisht hartimit të sistemit për sigurimin e jashtëm të cilësisë, institucioni ofron bazat për sigurimin e jashtëm të cilësisë përmes vetë-vlerësimit, ose duke mbledhur material të tjera që mbështesin të dhënat. Dokumentacioni i shkruar kompletohet normalisht nga intervistat me palët e intervistuarat gjatë vizitës në terren. Gjetjet e vlerësimit përmbledhen në një raport (Standardi 2.5) të shkruar nga një grup ekspertësh të jashtëm (Standardi 2.4).

Sigurimi i jashtëm i cilësisë nuk mbaron me raportin e ekspertëve. Ky raport jep udhëzime të qarta për veprimin institucional. Natyra e përcjelljes më pas do të varet nga hartimi i sigurimit të jashtëm të cilësisë.

## 2.4 Ekspertët homologë për vlerësim

Standardi:

Sigurimi i jashtëm i cilësisë duhet të kryhet nga grupe ekspertësh të jashtëm që përfshijnë (një) anëtar(ë) student(ë).

### Udhëzime:

Në bazën e sigurimit të jashtëm të cilësisë është një varietet i gjerë ekspertize i ofruar nga ekspertët vlerësues homologë, që kontribuojnë në punën e agjencive përmes dhënies së perspektivave të ndryshme, duke përfshirë ato të institucioneve, akademikëve, studentëve dhe të punësuarve/praktikantëve profesionalë.

Në mënyrë që të garantohet vlera dhe konsistenca e punës së ekspertëve, ata

- përzgjidhen me kujdes;
- kanë aftësi të përshtatshme dhe janë kompetentë në kryerjen e detyrës së tyre;
- janë të mbështetur nga trajnime dhe/ose udhëzime të përshtatshme

Agjencia garanton pavarësinë e ekspertëve duke zbatuar një mekanizëm për mungesën e konfliktit të interesit.

Përfshirja e ekspertëve ndërkombëtarë në sigurimin e jashtëm të cilësisë, për shembull si anëtarë të paneleve homologe, është e dëshirueshme pasi që i shton një dimension tjetër proceseve të zhvillimit dhe të zbatimit.



## 2.5 Kriteret për rezultatet

### **Standardi:**

Çdo rezultat ose gjykim i bërë si rezultat i sigurimit të jashtëm të cilësisë duhet të bazohet në kritere të qarta dhe të publikuara që aplikohen në mënyrë konsistente, pavarësisht nëse procesi çon të një vendim zyrtar .

### **Udhëzime:**

Sigurimi i jashtëm i cilësisë dhe në veçanti rezultatet e tij kanë një ndikim domethënës në institucionet dhe programet që vlerësohen dhe gjykohen.

Në interes të barazisë dhe besueshmërisë, rezultatet e sigurimit të jashtëm të cilësisë bazohen në kritere të paracaktuara dhe të publikuara, që interpretohen në mënyrë të vazhdueshme dhe janë të bazuara në të dhëna. Varësisht sistemit të sigurimit të jashtëm të cilësisë, rezultatet mund të marrin forma të ndryshme, për shembull, rekomandime, gjykime ose vendimmarrje zyrtare.

## 2.6 Raportimi

### **Standardi:**

Raportet e plota të ekspertëve duhet të jenë të botuara, të qarta dhe të qasshme për komunitetin akademik, partnerët e jashtëm dhe individët e tjerë të interesuar. Nëse agjencia merr ndonjë vendim zyrtar të bazuar në raporte, vendimi duhet të jetë i publikuar bashkë me raportin.

### **Udhëzime:**

Raporti i ekspertëve është baza për veprimet e ardhshme të institucionit për vlerësimin e jashtëm dhe i jep informacion shoqërisë lidhur me aktivitetet e institucionit. Në mënyrë që raporti të përdoret si bazë për veprim, duhet të jetë i qartë dhe konciz në strukturën dhe në gjuhën e tij dhe të mbulojë

- përshkrimin e kontekstit (të ndihmojë vendosjen e institucionit të arsimit të lartë në kontekstin e tij specifik)
- përshkrimin e procedurës individuale, duke përfshirë ekspertët;
- të dhënat, analizën dhe gjetjet;
- përfundimet;
- tiparet e praktikës së mirë, të demonstruar nga institucioni;
- rekomandimet për veprimet e ardhshme.

Përgatitja e raportit përmbledhës mund të jetë e dobishme.

Saktësia faktike e raportit përmirësohet nëse institucionit i jepet mundësia për të vënë në dukje gabimet përpara se raporti të përfundohet.

## 2.7 Ankesat dhe apelimet

### **Standardi:**

**Proceset e ankesave dhe apeliemeve duhet të përcaktohen qartë si pjesë e hartimit të proceseve për sigurimin e jashtëm të cilësisë dhe t'u komunikohen institucioneve.**

### **Udhëzime:**

Në mënyrë që të ruhen të drejtat e institucionit dhe të garantohet vendim-marrja e drejtë, siguri i jashtëm i cilësisë vepron në një mënyrë të hapur dhe të përgjegjshme. Megjithatë, mund të ketë keqkuptime apo instance pakënaqësie rreth procesit të rezultateve zyrtare.

Institucionet kanë nevojë të kenë qasje në proceset që u mundësojnë atyre të ngrenë çështje shqetësuese me agjencitë; agjencitë kanë nevojë të trajtojnë këto çështje në një mënyrë profesionale nëpërmjet një procesi të përcaktuar qartësisht që zbatohet në mënyrë konsistente.

Procedura e ankimit i mundëson institucionit të deklarojë pakënaqësinë e tij lidhur me procesin apo me ata që e kryejnë atë.

Në procedurën e apëlimit, institucioni vë në pikëpyetje rezultatet formale të procesit, ku mund të demonstrojë se rezultatet nuk janë bazuar mbi të dhëna bindëse, që kriteret nuk janë zbatuar në mënyrë korrekte apo që proceset nuk janë zbatuar në mënyrë konsistente.

## **Pjesa 3: Standardet dhe udhëzimet për agjencitë e sigurimit të cilësisë**

### **3.1 Aktivitete, politikat dhe proceset për sigurimin e cilësisë**

**Standardi:**

Agjencitë duhet të ndërmarrin aktivitete për sigurimin e jashtëm të cilësisë siç është përcaktuar në Pjesën 2 të ESG në mënyrë të rregullt. Ato duhet të kenë qëllime dhe objektiva të qarta që janë pjesë e deklaratës së tyre publike. Ato duhet të përkthehen në punën e përditshme të agjencisë. Agjencitë duhet të sigurojnë përfshirjen e palëve të interesuara në qeverisjen dhe punën e tyre.

**Udhëzime:**

Për të garantuar rëndësinë dhe kuptimin e plotë të sigurimit të jashtëm të cilësisë, është me rëndësi që institucionet dhe publiku të kenë besim tek agjencitë.

Për këtë arsye, qëllimet dhe objektivat e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë përshkruhen dhe botohen bashkë me natyrën e ndërveprimit midis agjencive dhe aktorëve relevant në arsimin e lartë, veçanërisht të institucioneve të arsimit të lartë dhe qëllimit të punës së agjencive. Ekspertiza në agjenci mund të rritet duke përfshirë anëtarë ndërkombëtarë në komisionet e agjencisë.

Nga ana e agjencive mbahet një varietet i aktiviteteve të sigurimit të jashtëm të cilësisë për të arritur objektiva të ndryshme. Mes tyre janë vlerësimi, rishikimi, auditimi, akreditimi ose aktivitetet të tjera të ngjashme në nivel programi dhe në nivel institucional që mund të kryhen në mënyra të ndryshme. Kur Agjencitë kryejnë aktivitete të tjera, është i nevojshëm një dallim i qartë mes sigurimit të jashtëm të cilësisë dhe fushave të tjera të punës.

### 3.2 Statusi zyrtar

**Standardi:**

Agjencitë duhet të kenë një bazë ligjore dhe duhet të njihen zyrtarisht si agjenci për sigurimin e cilësisë nga autoritetet publike kompetente.

**Udhëzime:**

Në veçanti, kur sigurimi i jashtëm i cilësisë kryhet për qëllime rregulluese, institucionet kanë nevojë të kenë sigurinë se rezultatet e këtij procesi pranohen brenda sistemit të arsimit të lartë, nga shteti, palët e interesuara dhe publiku.

### 3.3 Pavarësia

**Standardi:**

Agjencitë duhet të jenë të pavarura dhe të veprojnë në mënyrë autonome. Ato duhet të kenë përgjegjësi të plotë për veprimet e tyre dhe rezultatet e këtyre veprimeve pa ndikimin e palëve të treta.

**Udhëzime:**

Institucionet autonome kanë nevojë për agjenci të pavarura si homologët e tyre.

Në shqyrtimin e pavarësisë së një agjencie janë të rëndësishme si më poshtë:

- Pavarësia organizative, e demonstruar nga dokumentacioni zyrtar (p.sh. instrumentet e qeverisë, aktet ligjore ose statutet e organizatës) që përcaktojnë pavarësinë e punës së agjencisë nga palët e treta, si për shembull institucionet e arsimit të lartë, qeveritë dhe organizatat e tjera të interesuara;
- Pavarësia operationale: përkufizimi dhe operimi i procedurave dhe metodave të agjencisë, si dhe nominimi dhe caktimi i ekspertëve të jashtëm janë ndërmarr në mënyrë të pavarur nga palët e treta, si për shembull institucionet e arsimit të lartë, qeveritë dhe palët e tjera të interesuara;
- Pavarësia e rezultateve formale: përderisa ekspertët që vijnë nga lëmi përkatëse, veçanërisht studentët, marrin pjesë në proceset e sigurimit të cilësisë, rezultatet përfundimtare të proceseve të sigurimit të cilësisë mbeten përgjegjësi e agjencisë.

Çdokush që kontribuon në aktivitete e sigurimit të jashtëm të cilësisë së një agjencie (p.sh. ekspertët) është i informuar se përderisa ata mund të nominohen nga një palë e tretë, ata veprojnë në cilësinë e tyre personale dhe nuk përfaqësojnë organizatat konstituuese kur punojnë për agjencinë. Pavarësia është e rëndësishme për të garantuar se çdo procedurë apo vendim bazohet vetëm mbi ekspertizën.

### 3.4 Analiza tematike

**Standardi:**

Agjencitë duhet të botojnë në mënyrë të rregullt raporte që përshkruajnë dhe analizojnë gjetjet e përgjithshme të aktiviteteve të tyre për sigurimin e jashtëm të cilësisë.

**Udhëzime:**

Gjatë punës së tyre, agjencitë përftojnë informata mbi programet dhe institucionet që mund të përdoren përtej qëllimeve të një procesi të vetëm, duke ofruar material për analiza të strukturuar në sistemin e arsimit të lartë. Këto gjetje mund të kontribuojnë në reflektimin dhe përmirësimin e politikave dhe proceseve për sigurimin e cilësisë në kontekste institucionale, kombëtare dhe ndërkombëtare.

Një analizë e plotë dhe e kujdesshme e këtij informacioni do të tregojë zhvillimet, prirjet dhe fushat e praktikës së mirë ose vështirësitë e vazhdueshme .

### 3.5 Burimet

**Standardi:**

Agjencitë duhet të kenë burime të përshtatshme dhe të duhura, si njerëzore, ashtu dhe financiare për të kryer punën e tyre.

**Udhëzime:**

Është në interesin e tyre publik që agjencitë të jenë të financuara në mënyrë të përshtatshme dhe të duhur, duke marrë parasysh ndikimin e rëndësishëm të arsimit të lartë në zhvillimin e shoqërive dhe individëve. Burimet e agjencive i mundësojnë atyre të organizojnë dhe të drejtojnë aktivitete e sigurimit të jashtëm të cilësisë në një mënyrë efektive dhe efçente. Për më tepër, burimet i mundësojnë agjencive të përmirësojnë, të reflektojnë mbi praktikën e tyre dhe të informojnë publikun për aktivitetet e tyre.

### 3.6 Sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe administrimi profesional

**Standardi:**

**Agjencitë duhet të kenë procese për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhur me përcaktimin, garantimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe integritetit të aktiviteteve të tyre.**

**Udhëzime:**

Agjencitë kanë nevojë të jenë të përgjegjshme kundrejt palëve të interesuara. Prandaj, standardet e larta profesionale dhe integriteti në punën e Agjencisë janë të domosdoshme. Rishikimi dhe përmirësimi i aktiviteteve të tyre janë të vazhdueshme në mënyrë që të garantojnë që shërbimet e tyre për institucionet dhe shoqërinë janë optimale.

Agjencitë aplikojnë një politikë për sigurimin e brendshëm të cilësisë që të jetë i pasqyruar në ueb faqen e tyre. Kjo politikë

- garanton që të gjithë personat e përfshirë në aktivitetet e saj të jenë kompetentë dhe të veprojnë në mënyrë profesionale dhe etike;
- përfshin mekanizmat e reagimit të brendshëm dhe të jashtëm që sjellin një përmirësim të vazhdueshëm brenda agjencisë;
- mbrohet kundër çdo lloj intolerance dhe diskriminimi;
- përshkruan komunikimin e përshtatshëm me autoritete relevante të juridiksioneve ku operon;
- garanton që çdo aktivitet i kryer dhe çdo material i prodhuar nga të nënkontraktuarit të jenë në përputhje me ESG, nëse disa ose të gjithë elementët në aktivitetet e sigurimit të cilësisë janë të nënkontraktuara me palë të tjera;

- i mundëson agjencisë të vendosë statusin dhe njohjen e institucioneve me të cilët ajo administron sigurimin e jashtëm të cilësisë.

### 3.7 Rishikimi i jashtëm ciklik i Agjencive

**Standardi:**

**Agjencitë duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi të jashtëm çdo pesë vjet në mënyrë që të tregojnë përputhshmërinë e tyre me ESG.**

**Udhëzime:**

Një vlerësim i jashtëm periodik do të ndihmonte agjencinë të reflektonte mbi politikën dhe aktivitetet e saj. Ajo garanton mjetet për të siguruar se agjencia dhe palët e interesuara të vazhdojnë të aderojnë në parimet e sanksionuara në ESG.



### **III. Shtojca: Lista përmbledhëse e standardeve**

#### **Pjesa 1: Standardet për sigurimin e brendshëm të cilësisë**

##### **1.1 Politika për sigurimin e cilësisë**

Institucionet duhet të kenë një politikë për sigurimin e cilësisë që është publike dhe bën pjesë në menaxhmentin e tyre strategjikë. Aktorët e brendshëm duhet të zhvillojnë dhe të zbatojnë këtë politikë përmes strukturave dhe proceseve të përshtatshme, ndërsa përfshijnë palët e jashtme<sup>7</sup>.

##### **1.2 Hartimi dhe miratimi i programeve<sup>8</sup>**

Institucionet duhet të kenë procese për hartimin dhe miratimin e programeve të tyre. Programet duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të përmbushin bashkësinë e objektivave, duke përfshirë rezultatet mësimore të synuara. Kualifikimi që rezulton nga program duhet të jetë i specifikuar dhe i komunikuar qartësisht dhe t'i referohet nivelit korrekt për kornizën e kualifikimeve kombëtare për arsimin e lartë, dhe rrjedhimisht Kornizës për Kualifikime të Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë.

##### **1.3 Mësimnxënia, mësimdhënia dhe vlerësimi me studentin në qendër**

Institucionet duhet të garantojnë që programet të ofrohen në një mënyrë që i inkurajon studentëve të kenë një rol aktiv në krijimin e proceseve mësimore dhe që vlerësimi i studentëve të reflektojë këtë qasje.

##### **1.4 Pranimi, progresi, njohja dhe certifikimi i studentëve**

Institucionet duhet të aplikojnë në mënyrë vazhdueshme rregullore të paracaktuara dhe të botuara që mbulojnë të gjitha fazat e “ciklit jetësor” të studentit, p.sh. pranimi, progresi, njohja dhe certifikimi i studentit.

##### **1.5 Stafi mësimdhënës**

---

<sup>7</sup>Nëse nuk është specifikuar ndryshe, në dokument palët e interesuara duhet të mbulojnë të gjithë aktorët brenda institucionit, duke përfshirë studentët dhe stafin, si dhe palët e jashtme si punonjësit dhe partnerët e jashtëm të një institucioni.

<sup>8</sup>Termi “program” në këto standard i referohet dispozitave të arsimit të lartë në një kuptim të gjerë, duke përfshirë dispozitën që nuk është pjesë e programit dhe që çon në një gradë shkencore formale.

Institucionet duhet të sigurojnë veten për kompetencat e mësimdhënësve të tyre. Ato duhet të aplikojnë procese të ndershme dhe transparente për rekrutimin dhe zhvillimin e stafit.

### **1.6 Burimet mësimore dhe përkrahja e studentëve**

Institucionet duhet të kenë financim të përshtatshëm për aktivitetet e mësimnxënies dhe mësimdhënies dhe të garantojnë që burimet mësimore të përshtatshme dhe lehtësisht të qasshme, si dhe përkrahja e studentëve të ofrohen.

### **1.7 Menaxhimi i informatave**

Institucionet duhet të garantojnë se ato mbledhin, analizojnë dhe përdorin informacion relevant për menaxhim efektiv të programeve të tyre dhe aktiviteteve të tjera.

### **1.8 Informimi publik**

Institucionet duhet të botojnë informacion rreth aktiviteteve të tyre, duke përfshirë programet, që është i qartë, i saktë, objektiv, i përditësuar dhe lehtësisht qasshëm.

### **1.9 Monitorimi i vazhdueshëm dhe vlerësimi ciklik i programeve**

Institucionet duhet të monitorojnë dhe të vlerësojnë në mënyrë periodike programet e tyre për të garantuar se ato i arrijnë objektivat dhe i përgjigjen nevojave të studentëve dhe të shoqërisë. Këto vlerësime duhet të sjellin një përmirësim të vazhdueshëm të programit. Çdo veprim i planifikuar apo i marrë si pasojë duhet t'u komunikohet të gjithë të interesuarve.

### **1.10 Sigurimi i jashtëm ciklik i cilësisë**

Institucionet duhet t'i nënshtrohen sigurimit të jashtëm të cilësisë në përputhje me ESG mbi bazë ciklike.

## **Pjesa 2: Standardet për sigurimin e jashtëm të cilësisë**

### **2.1 Shqyrtimi i sigurimit të brendshëm të cilësisë**

Sigurimi i jashtëm i cilësisë duhet të adresojë efektshmërinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, të përshkruar në Pjesën 1 të ESG.

### **2.2 Hartimi i metodologjive në përputhje me qëllimin**

Sigurimi i jashtëm i cilësisë duhet të përcaktohet dhe të hartohet në mënyrë specifike për të garantuar përputhshmërinë e tij për të arritur qëllimet dhe objektivat, duke marrë

në konsideratë rregulloret përkatëse. Palët e interesuara duhet të përfshihen në hartimin e tij dhe në përmirësimin e tij të vazhdueshëm.

### **2.3 Proceset e zbatimit**

Proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë duhet të jenë të besueshme, të dobishme, të paracaktuara të implementuara në mënyrë konsistente dhe të botuara. Ato përfshijnë:

- një vetë-vlerësim ose të barasvlerëshmin e tij;
- një vlerësim të jashtëm duke përfshirë normalisht vizitën në terren;
- një raport që vjen nga vlerësimi i jashtëm;
- një përcjellje më pas të vazhdueshme.

### **2.4 Ekspertët homologë të vlerësimit**

Sigurimi i jashtëm i cilësisë duhet të kryhet nga grupe ekspertësh të jashtëm që përfshijnë (një) anëtar(ë) student(ë).

### **2.5 Kriteret për rezultatet**

Çdo rezultat apo gjykim i bërë si pasojë e sigurimit të jashtëm të cilësisë duhet të bazohet mbi kriteret të qarta dhe të publikuara që zbatohen në mënyrë konsistente, pavarësisht nëse procesi sjell një vendim formal.

### **2.6 Raportimi**

Raportet e plota nga ekspertët duhet të botohen, të qarta dhe të qasshme për komunitetin akademik, partnerët e jashtëm dhe individët e tjerë të interesuar. Nëse agjencia ndërmerr ndonjë vendim zyrtar të bazuar në raportet, vendimi duhet të publikohet së bashku me raportin.

### **2.7 Ankesat dhe apelimet**

Proceset e ankimimit dhe apelimet duhet të përcaktohen qartë si pjesë e hartimit të proceseve për sigurimin e jashtëm të cilësisë dhe t'u komunikohen institucioneve.

## **Pjesa 3: Standardet për agjencitë e sigurimit të cilësisë**

### **3.1 Aktivitetet, politikat dhe proceset për sigurimin e cilësisë**

Agjencitë duhet të ndërmarrin aktivitete për sigurimin e jashtëm të cilësisë siç është përcaktuar në Pjesën 2 të ESG në mënyrë të rregullt. Ato duhet të kenë qëllime dhe objektiva të qarta që janë pjesë e deklaratës së tyre publike. Ato duhet të përkthehen në

punën e përditshme të agjencisë. Agjencitë duhet të sigurojnë përfshirjen e palëve të interesuara në qeverisjen dhe punën e tyre.

### **3.2 Statusi zyrtar**

Agjencitë duhet të kenë një bazë ligjore dhe duhet të njihen zyrtarisht si agjenci për sigurimin e cilësisë nga autoritetet publike kompetente.

### **3.3 Pavarësia**

Agjencitë duhet të jenë të pavarura dhe të veprojnë në mënyrë anonime. Ato duhet të kenë përgjegjësi të plotë për veprimet e tyre dhe rezultatet e këtyre veprimeve pa ndikimin e palëve të treta.

### **3.4 Analiza tematike**

Agjencitë duhet të botojnë në mënyrë të rregullt raporte që përshkruajnë dhe analizojnë gjetjet e përgjithshme të aktiviteteve të tyre për sigurimin e jashtëm të cilësisë.

### **3.5 Burimet**

Agjencitë duhet të kenë burime të përshtatshme dhe të duhura, si njerëzore, ashtu dhe financiare për të kryer punën e tyre.

### **3.6 Sigurimi i brendshëm i cilësisë dhe administrimi profesional**

Agjencitë duhet të kenë procese për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhur me përcaktimin, garantimin dhe përmirësimin e cilësisë dhe integritetit të aktiviteteve të tyre.

### **3.7 Rishikimi i jashtëm ciklik i agjencive**

Agjencitë duhet t'i nënshtrohen një rishikimi të jashtëm çdo pesë vjet në mënyrë që të tregojnë pajtueshmërinë e tyre me ESG.